



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar–Dhjetor 2021



Prishtinë, 2022

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
Hyrje	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
1. KRITERET POLITIKE.....	7
1.1 Administrata Publike	7
1.2 Avokati i popullit.....	9
1.3 Shoqëria civile.....	9
1.4 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit	9
1.5 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore	11
2. KRITERET EKONOMIKE.....	13
2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut	13
2.2 Tatimet.....	13
2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë	14
3. STANDARDET EVROPIANE.....	14
3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale.....	14
3.2 Energjia.....	15
3.3 Statistikat.....	15
3.4 Gjyqësori dhe të drejtat themelore	16
3.5 Mbrojtja e minoriteteve.....	19
3.6 Drejtësia, liria dhe siguria	19
3.7 Menaxhimi i kufirit dhe migracioni	20
3.8 Arsimi dhe kultura.....	21
3.9 Mjedisi	22
3.10 Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik	22
4. VEPRIMET E NDËRMARRA NGA KOMUNAT ME RASTIN E COVID -19.....	23
REKOMANDIMET.....	24

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
EVSE	Ekipet Vepruese për Siguri
KE	Komisioni Evropian
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshillat Lokale për Siguri Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA-së

Hyrje

Ky raport paraqet implementimin e obligimeve të komunave, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërësht i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal është përkushtuar në përmbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, MAPL ka zhvilluar disa mënyra të adresimit tëçështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin e procesit të planifikimit, hartimin e planit të përgjithshme për obligimet e komunave në procesin e integritetit evropian, hartimin e planeve individuale të komunave si dhe hartimin e raportit të përmbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane për dy periudha brenda vitit Janar-Qershor dhe Janar-Dhjetor.

Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të nivelit lokal në fushën e integritetit evropian, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor2021 kanë raportuar38 Komuna të Republikës së Kosovës.Raporti është i bazuar në55 veprime/masa dhe 177 pyetje/indikator që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga komunat. MAPL në komuna ka adresuar të gjitha çështjet që burojnë nga PKZMSA, nga konkluzionet e nënkomiteteve sektoriale si dhe nga sfidat e raportit të KE-së për Kosovën. Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardet evropiane si dhe raporti pasqyron gjendjen reale të arriturve të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për vitet në vijim.Duke pasur parasysh zhvillimin e pandemisë COVID-19 dhe kontributin e komunave në këtë fazë, raporti përfshin edhe kapitullin e pandemisë COVID-19.

Nëkuadër të**kritereve politike**prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Administrata publike,
- Avokati i popullit,
- Shoqëria civile,
- Lufta kundër terrorizmit,
- Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor2021 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 56% të aktiviteteve të planifikuara për realizim.

Nëkuadër të**kritereve ekonomike**prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut,
- Tatimet,
- Ndërmarrjet, politikat e industrisë dhe tregu i brendshëm.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 74% të aktiviteteve të planifikuara për realizim.

Nëkuadër të**standardeve evropiane**, prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Bujqësi dhe zhvillimi rural,
- Energji,
- Gjyqësori dhe të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve,
- Drejtësi,
- Liria dhe siguria,

- Menaxhimi i kufirit dhe migracioni,
- Arsimi dhe Kultura,
- Mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit dheshëndetit publik.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 56% të aktiviteteve të planifikuara për realizim. Në total komunat kanë arritur t'i përmbushin 62% të obligimeve të komunave që burojnë nga Agjenda Evropiane, që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale.

Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar nga pandemia COVID-19 ku ishte e domosdoshme marrja e masave me qëllim të mbrojtjes të shëndetit publik, gjatë kësaj periudhe ka pasur pezullime të përkohshme të zhvillimit të aktiviteteve, të cilat kanë ndikuar në ulje të dukshme në përmbushjen e këtyre obligimeve. Në kuadër të kapitullit të pandemisë COVID-19 prezantohet menaxhimi i gjendjes së COVID-19 në nivel lokal duke përfshirë masat të cilat janë ndërmarr nga komunat konform udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.


1. KRITERET POLITIKE

1.1 Administrata Publike

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, 23 komuna kanë hartuar programin e trajnimeve ndërsa në 15 komuna (Ranillug, Deçan, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Podujevë, Prizren, Zveçan, Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj, Mamushë, Malishevë, Novobërdë, Zubin Potok) nuk është hartuar programi i trajnimeve për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave shohim se nga 38 komuna raportuese 8 komuna (Gjakovë, Vushtrri, Malishevë, Lipjan, Skenderaj, Graçanicë, Rahovec, Pejë) e kanë hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrdhënie me Publikun, ndërsa në 30 komuna (Gjilan, Shtime, Ranillug, Suharekë, Obiliq, Mamushë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Gllogoc, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Viti, Klokot, Istog, Podujevë, Prizren, Zveçan, Prishtinë, Partesh, Fushë Kosovë, Hani Elezit) ende nuk është hartuar kjo strategji. Nga të dhënat, shihet se një pjesë e madhe e komunave ende nuk kanë hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrdhënie me Publikun si rrjedhojë e stafit të reduktuar në punë për shkak të pandemisë COVID-19, mungesës së stafit profesional për hartim të strategjive sidomos sektorin e komunikimit publik etj.



Grafikoni 1: Programi i trajnimeve dhe Strategjia për komunikim dhe marrdhënie me publikun

Po ashtu është parë nivel i ulët i hartimit të planit vjetor të komunikimit ku deri më tani vetëm 10 komuna kanë hartuar planin vjetor të komunikimit, ndërsa 28 komuna (*Gjilan, Shtime, Ranillug, Suharekë, Obiliq, Mamushë, Ferizaj, Lipjan, Novobërdë, Zubin Potok, Dragash, Kaçanik, Pejë, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Klokot, Istog, Podujevë, Prizren, Zveçan, Prishtinë, Partesh, Fushë Kosovë, Malishevë, Gjakovë, Vushtrri*) nuk kanë plan vjetorë të komunikimit.

Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik, janë 31 komuna të cilat kanë raportuar se është duke u zbatuar ky udhëzim, në 3 komuna (*Lipjan, Novobërdë, Vitis*) është raportuar se është duke u zbatuar pjesërisht si dhe në 4 komuna (*Ferizaj, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok*) është deklaruar se ky udhëzim nuk është duke u zbatuar.

Mirëpo nëse shohim të dhënat e paraqitura në vijim mund të vërejmë që akoma nuk është në nivel të duhur zbatimi i udhëzimit administrativ, pasi që rezultatet e konsultimit publik me raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit publikohen vetëm në 15 komuna, ndërsa në 23 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Suharekë, Klinë, Junik, Kaçanik, Graçanicë, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Viti, Obiliq, Lipjan, Malishevë, Ranillug, Shtime, Vushtrri, Mamushë, Ferizaj, Zubin Potok*) nuk publikohen.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësia/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani janë vetëm 17 komuna kanë caktuar zyrtarin përgjegjës, në 17 komuna (*Gjilan, Shtime, Ranillug, Mamushë, Zubin Potok, Podujevë, Viti, Istog, Zveçan, Prishtinë, Fushë Kosovë, Deçan, Dragash, Klinë, Junik, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut*) nuk është caktuar si dhe në 4 komuna (*Ferizaj, Vushtrri, Novobërdë, Hani Elezit*) është caktuar përgjegjëse zyra për komunikim me publikun.

Sipas të dhënave të raportuara, nga katër komunat e veriut të Republikës së Kosovës, në 3 komuna (*Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut*) kanë themeluar drejtoritë komunale dhe janë emëruar drejtorët e drejtorive ndërsa në 1 komunë (*Zveçan*) nga 13 drejtori komunale të parapara me statut të komunës janë emëruar vetëm 3 drejtori komunale. Sa i përket themelimit të qendrave për shërbim të qytetarëve në 3 komuna (*Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok*) nuk janë themeluar ndërsa në 1 komunë (*Mitrovicë Veriore*) është themeluar.

Sistemi i intranetit në kuadër të shërbimeve administrative që ofron komuna dhe sipas raportimeve të bëra nga komunat, është duke funksionuar në 4 komuna (*Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan*).

Sipas të dhënave të pranuar nga komunat numri i të punësuarave të komuniteteve jo shumicë, në 30 komuna është 462 të punësuar nga radhët e komuniteteve joshumicë, në 1 komunë

(Kaçanik) nuk ka të punësuar të komuniteteve jo shumicë, 3 komuna (Glogoc, Junik, Hani Elezit) nuk kanë komunitete jo shumicë si dhe 4 komuna (Ranillug, Mamushë, Graçanicë, Pejë) nuk ka ofruar informacione.

1.2 Avokati i popullit

Rritja e përgjegjësisë së qeverisjes lokale karshi kërkesave/rekomandimeve nga Avokati i Popullit për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për qeverisjen lokale mbetet prioritet edhe gjatë vitit 2021, nga 38 komuna janë 12 komuna (Gjilan, Lipjan, Ferizaj, Obiliq, Vushtrri, Viti, Zveçan, Partesh, Prishtinë, Fushë Kosovë, Skenderaj, Mitrovicë Veriore) të cilat kanë pranuar 22 kërkesa/rekomandime nga Institucioni i Avokatit të Popullit, ku prej tyre janë kthyer 13 përgjigje pozitive dhe 6 kërkesa gjenden në proces të shqyrtimit.

1.3 Shoqëria civile

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranuar një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Në 28 komuna është ndarë buxhet në vlerë 2,191,156.34 euro. ndërsa 10 komuna (Ranillug, Mamushë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Deçan, Junik, Shtërpçë, Klokot, Partesh) nuk ka ndarë buxhet. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur 1025 OJQ me 3405 projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të shoqëris civile në projekte komunale janë 28 komuna që kanë ndërmarr këto veprime: *informime përmes radiove lokale, rrjeteve sociale dhe thirrjeve në ueb faqe komunale, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës për plotësimin e dokumentet aplikuese, trajtim i barabart dhe mosdiskriminim i aplikuesve, janë krijuar lehtësira respektivisht në ofrimin e infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin e projekteve, bashkëpunim ingusht me OJQ, përkrahje për projektet multi-etnike etj.* Kurse 10 komuna (Mamushë, Zubin Potok, Deçan, Rahovec, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Klokot, Hani Elezit, Partesh) nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim.

1.4 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit

Një ndër objektivat e cila buron edhe nga strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është ngritja e kapaciteteve të institucioneve për të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit, më këtë qëllim në 8 komuna (Gjilan, Suharekë, Obiliq, Mamushë, Mitrovicë Jugore, Partesh, Prishtinë, Prizren) në bashkëpunim nivelin qendror dhe donatorë janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm kurse 30 komuna (Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Lipjan, Novobërdë, Zubin Potok,

Vushtrri, Shtime, Ferizaj, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Pejë, Junik, Rahovec, Gllogoc, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Istog, Klllokot, Podujevë, Zveçan, Hani Elezit, Kamenicë, Viti) nuk është organizuar asnjë trajnim.


Për mbështetjen dhe parandalimin e luftës kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë 7 komuna (*Gjilan, Ferizaj, Deçan, Istog, Mitrovicë Jugore, Kamenicë, Viti*) të cilat kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit si: *janë zhvilluar takime me rinin, gra dhe strukturat arsimore me qëllim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në rritjen e ekstremizmit, gjithashtu janë bërë diskutime në Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, në disa komuna është hartuar Strategjia komunale për ndalimin e veprimeve të dhunshme, janë mbajtur takime të rregullta përmes këshillave lokale dhe imamëve të xhamive lokale. etj*, ndërsa 31 komuna (*Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Suharekë, Mamushë, Lipjan, Novobërdë, Vushtrri, Shtime, Obiliq, Zubin Potok, Dragash, Klinë, Kaçanik, Pejë, Junik, Rahovec, Gllogoc, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Klllokot, Podujevë, Prizren, Hani Elezit, Partesh, Podujevë, Viti*) nuk janë ndërmarr asnjë veprim. Në 38 komuna nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Në bashkëpunim me nivelin qendror në 14 komunë janë krijuar hapësirat e sigurta në shkolla për nxënësit që të bëjnë pyetje privatisht rreth çështjeve të ndjeshme sociale ose identitetit me praktikues trajnuar (pedagog, psikolog, sociolog etj.) në veçanti duke ju kushtuar rëndësi zonave më të targetuara nga radikalizmi derisa në 24 komuna (*Gjakovë, Gjilan, Malishevë, Ranillug, Suharekë, Novobërdë, Zubin Potok, Vushtrri, Shtime, Mamushë, Pejë, Junik, Rahovec, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Klllokot, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Prizren, Zveçan, Hani Elezit*) nuk ka hapësira të tilla.

Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunat në vazhdimësi në rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit. Gjatë vitit 2021, në 32 komuna nuk ka pasur asnjë rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kurse në 6 komuna (*Gjakovë, Shtime, Ferizaj, Gllogoc, Mitrovicë Jugore, Prizren*) janë deklaruar 7 raste. Sa i përket anëtarëve të kuvendit, që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës janë 3 komuna (*Podujevë, Fushë Kosovë, Leposaviq*) që kanë deklaruar 4 raste të cilat kanë paraqitur konflikt të interesit.

Planin Lokal për Integritet është hartuar në 12 komuna ndërsa në 26 komuna (*Shtime, Ranillug, Obiliq, Mamushë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Viti, Klllokot, Istog, Podujevë, Prizren, Zveçan, Prishtinë, Partesh, Fushë Kosovë, Gjilan, Malishevë*) ende nuk është hartuar ky plan. Pjesa më e madhe e komunave nuk e kanë të emëruar zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit, nga 38 komunat raportuese vetëm 12 komuna kanë caktuar zyrtarin përkatës, ndërsa në 27 komuna (*Gjilan, Shtime, Malishevë, Ranillug, Suharekë, Obiliq, Mamushë, Ferizaj, Novobërdë, Deçan, Dragash, Klinë, Junik, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Podujevë, Kamenicë, Hani*

Elezit, Klllokot, Mitrovicë Jugore, Istog, Prizren, Zveçan, Prishtinë, Fushë Kosovë) nuk ende nuk e kanë caktuar zyrtarin përkatës.



Grafikoni 2: Programi i trajnimeve dhe Strategjia për komunikim dhe marrdhënie me publikun

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë 33 komuna të cilat kanë ndërmarr veprimet si: *organizim i trajnimeve, kurse për gjuhën serbe dhe shqipe, janë punësuar zyrtarë për përkthim, ofrohen shërbime simulante nëpër të gjitha takimet zyrtare, materialet e organeve komunale përkthehen të gjitha në gjuhë zyrtare, shpërndahen broshura të ndryshme për promovimin e të drejtave gjuhësore për të gjitha komunitetet, ndërsa 5 komuna (Vushtrri, Malishevë, Obiliq, Podujevë, Hani Elezit) nuk kanë ndërmarr veprime. Ashtu siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe në rregulloret komunale për gjuhët zyrtare, në 33 komuna bëhet publikimi i akteve komunale në gjuhët zyrtare, ndërsa në 4 komuna (Malishevë, Suharekë, Podujevë, Viti) publikimi i akteve bëhet pjesërisht si dhe 1 komunë Zubin Potokut nuk ka ofruar informacione.*

1.5 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave të komunave janë vetëm 6 komuna (*Vushtrri, Rahovec, Pejë, Junik, Skenderaj, Prizren*) që është hartuar plani për trashëgimi kulturore.

Për ndërgjegjësimin dhe promovimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në 27 komuna janë ndërmarr aktivitetet si në vijim: *fushata vetëdijësuese, shpërndarje të broshurave të ndryshme për trashëgimisë kulturore, organizime të vizitave në muze për nxënës të shkollave të mesme dhe student, emisione promovuese në mediat lokale, organizimi i tryezave promovuese të trashëgimisë kulturore, subvencionim i projekteve për promovimin e trashëgimisë kulturore nga OJQ-të dhe individët, organizimi i ekspozitave kolektive të pikturës, bashkëpunimi me donatorë mbështetës për restaurimin e*

objekteve të trashëgimisë kulturore, shenjëzimi i aseteve të Trashëgimisë Kulturore, janë punuar guida, harta tëmonumenteve, renovimi i objekteve tëtrashëgimis kulturore, harta dixhitale, janë ridizajnuar të gjitha panelet informative turistike, janë botuar libra nga ekspertët e kësaj lëmie.Ndërsa në 11 komuna (Ranillug, Novobërdë, Mamushë,Klinë, Kaçanik, Shtërpcë, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Hani Elezit, Viti) nuk ka pasur aktivitete.

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 5 raste të ndërtimeve pa leje në 3 komuna (Gjilan, Obiliq, Istog)për të cilat janë ndërmarrë këto masa: *është njoftuar inspektorati për Trashëgimi Kulturore, janë ndërprerëpunimet deri në marrjen e lejes nga organet kompetente ku ka pasur raste të tilla.*

Po ashtu, në 17 komuna janë vendosur pajisjet për monitorimin e sigurisë të objekteve të trashëgimisë kulturore/kishave ortodokse, në5 komuna(Suharekë, Obiliq, Novobërdë, Istog, Kamenicë) janë siguruar pjesërisht si dhe 16 komuna (Gjilan, Malishevë, Ranillug, Ferizaj, Vushtrri, Shtime, Rahovec, Junik, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë Jugore, Partesh, Prishtinë, Zveçan, Hani Elezit, Viti) nuk janë siguruar paisjet për monitorim.

Në 4 komuna(Gjakovë, Rahovec, Klinë, Shtërpcë) janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse, në 30 komuna, nuk kanë nënshkruar Memorandume, si dhe 4 komuna(Mamushë, Junik, Dragash, Gllogoc) nuk kanë Kisha Ortodokse.

Për funksionimin e Këshillit të fshtatit për Hoçën e Madhe, komuna e Rahovecit ka siguruar një zyrë në komunë për mbajtjen e mbledhjeve dhe aktivitetet tjera gjithashtu për këtë periudhë është alokuar buxhet në vlerë prej 25.028.00 euro.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar-Dhjetor 2021 komuna e Prizrenit nuk ka alokuar buxhet. Nuk ka pasur asnjë ndërtim ilegal brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit. Është filluar procesi i legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje si dhe janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit. Gjithashtu komuna e Prizrenit me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi ka ndërmarrë aktivitete si: *mbrojtja e shtratit të lumit, rehabilitimi i urave të qytetit, mbrojtja nga ujërat e zeza,pastrimi i lumit etj*

Në Komunën e Fushë Kosovës është bërë studimi i fizibilitetit për themelimin e Muzeut të Natyrës i cili është duke u ndërtuar në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

2. KRITERET EKONOMIKE

2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut

Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese përfshirë regjistrimet e tyre, andaj janë 31 komuna të cilat kanë funksionalizuar këto qendra ndërsa mbetet në 7 komuna (*Malishevë, Mamushë, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan, Prishtinë, Junik*) funksionalizimi i tyre.

Numri i inspektorëve të tregut në 30 komuna është 53, ndërsa janë 8 komuna (*Prishtinë, Zveçan, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Zubin Potok, Mamushë*) nuk kanë inspektor të tregut.

Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 29 komuna janë mbajtur 188 dëgjime publike, kurse në 9 komuna (*Obiliq, Novobërdë, Zubin Potok, Graçanicë, Pejë, Kamenicë, Kllokot, Partesh, Prishtinë*) nuk kanë mbajtur asnjë dëgjim publik.

2.2 Tatimet

Me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale në 33 komuna janë ndërmarr masat si: *vërejtje me shkrim, kontrolla të vazhdueshme, ofrim i këshillave të nevojshme për të vepruar ligjshëm, ndërmarrja e masave ndaj subjekteve të cilat kanë ushtruar veprimtarin pa qenë të regjistruara, gjoba mandatore, mbyllja e përkohshme e subjekteve ekonomike, lirimi nga taksat komunale etj.* Në 5 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan*) nuk është ndërmarr asnjë veprim.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 nga 38 komuna raportuese, 31 komuna kanë pranuar 348 rekomandime nga Zyra Kombëtare e Auditimit, prej tyre 188 rekomandime janë të adresuar, 67 rekomandime të pa adresuara dhe pjesa tjetër e rekomandimeve gjendet në proces. Nga këto rekomandime, 124 rekomandime janë rekomandime financiare dhe 30 rekomandime të performancës. Për përmisimin e menaxhimit të financave lokale, në 33 komuna janë ndërmarr masat si: *vërejtje me shkrim, kontrolla të vazhdueshme, ofrim i këshillave të nevojshme për të vepruar ligjshëm, ndërmarrja e masave ndaj subjekteve të cilat kanë ushtruar veprimtarin pa qenë të regjistruara, Gjoba mandatore, mbyllja e përkohshme e subjekteve ekonomike, lirimi nga taksat komunale etj.* Në 5 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan*) nuk është ndërmarr ndonjë veprim.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 30 komuna, ndërsa janë 8 komuna (*Mamushë, Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Kllokot, Zveçan, Partesh, Hani Elezit*) të cilat ende nuk e kanë funksionale këtë njësi, në këto komuna janë respektuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në proceset e auditimit. Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 14 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës

komunale ndërsa në 24 komuna (*Mamushë, Novobërdë, Malishevë, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Pejë, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Klllokot, Partesh, Podujevë, Zveçan, Hani Elezit, Kamenicë, Viti, Vushtrri, Obiliq, Shtime, Ranillug, Ferizaj, Suharekë, Lipjan*) nuk është publikuar regjistri komunal.

2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

Në 8 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, ndërsa në 25 komuna (*Gjakovë, Gjiilan, Vushtrri, Shtime, Ranillug, Malishevë, Obiliq, Mamushë, Ferizaj, Lipjan, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Kaçanik, Pejë, Junik, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Klllokot, Podujevë, Zveçan, Kamenicë, Viti, Partesh, Prishtinë*) ende nuk është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, në 1 komunë (*Suharekë*) është bërë pjesërisht si dhe në 4 komuna (*Novobërdë, Fushë Kosovë, Istog, Hani Elezit*) nuk ka zona ekonomike.

3 STANDARDET EVROPIANE

3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Në sektorin e bujqësisë sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që vetëm 7 komuna (*Lipjan, Gjakovë, Kamenicë, Prizren, Prishtinë, Junik, Glogoc*) kanë hartuar Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa Planin për Menaxhimin e Tokave Rurale është i hartuar vetëm në 3 komuna (*Kamenicë, Istog, Podujevë*).

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, në 21 komuna janë parashtruar 481 kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës, ndërsa në 17 komuna (*Gjiilan, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Mamushë, Klinë, Rahovec, Glogoc, Skenderaj, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Zveçan, Partesh, Prishtinë*) nuk ka pasur kërkesa të parashtruara, krahas kësaj për këto kërkesa janë nxjerr 361 vendime.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në 29 komuna janë të funksionalizuara qendrat informative, ndërsa në 9 komuna (*Zubin Potok, Kaçanik, Pejë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Podujevë, Prizren, Zveçan*) ende nuk janë funksionalizuar. Për mbështetjen e fermerëve për kultivimin e bujqësisë janë 23 komuna të cilat kanë ofruar mbështetje për 4466 fermerë në sektorësi: *blegtorisë, hortikulturës, perimtarisë, shpeztarietj*, ndërsa 15 komuna (*Shtime, Malishevë, Mamushë, Vushtrri, Ranillug, Novobërdë, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Junik, Rahovec, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Klllokot*) nuk kanë ofruar mbështetje për fermerët.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore, 10 komuna (*Lipjan, Mitrovicë Jugore, Glllogoc, Graçanicë, Shtërpçë, Pejë, Junik, Suharekë, Obiliq, Ferizaj*) kanë ndërmarr fushata vetëdijesuse/trajnime, ndërsa 28 komuna nuk kanë mbajtur asnjë fushatë.

Janë 7 komuna të cilat kanë inspektorë të bujqësisë, derisa janë 31 komuna (*Gjilan, Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Suharekë, Obiliq, Mamushë, Ferizaj, Lipjan, Novobërdë, Zubin Potok, Dragash, Kaçanik, Pejë, Junik, Glllogoc, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Istog, Klllokot, Mitrovicë Jugore, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Zveçan, Hani Elezit, Kamenicë, Viti*) të cilat ende nuk kanë inspektorë të bujqësisë. Në shumicën e komunave ku nuk ka inspektor të bujqësisë në këto raste inspektimet realizohen nga inspektori sanitar, inspektori regjional, inspektori i veterinarisë, inspektori i ndërtimit, inspektorët nga Zyra Rajonale e AUVK-ut, nga niveli qendror dhe koordinatori i bujqësisë. Numri i inspektimeve bujqësore në 14 komuna është 10745, kurse 24 komuna (*Gjilan Ferizaj Obiliq, Ranillug, Zubin Potok Suharekë, Malishevë, Mamushë, Dragash, Kaçanik, Pejë, Junik, Glllogoc, , Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Istog, Zveçan, Prishtinë, Fushë Kosovë, Hani Elezit*) nuk kanë pasur inspektime. Në 10 komuna numri i fletëparaqitjeve të parashtruara është 294 ndërsa në 28 komuna (*Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Malishevë, Mamushë, Ferizaj, Gjilan, Deçan, Dragash, Kaçanik, Pejë, Junik, Glllogoc, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Klllokot, Zveçan, Podujevë, Partesh, Prishtinë, Fushë Kosovë, Hani Elezit*) nuk ka pasur asnjë fletëparaqitje të parashtruar.

3.2 Energjia


Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA komunat në vazhdimësi kanë bërë zhvillime të mëtejme në politikat e fushës së eficiencës së energjisë. Hartimi i planeve komunale për eficiencën të energjisë është një ndër progreset e cili është specifikuar edhe në raportin e KE-së për Kosovën sepse deri më tani janë 30 komuna të cilat kanë hartuar planin për eficiencë të energjisë, ndërsa vetëm 8 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Dragash, Pejë, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Malishevë*) ende nuk e kanë këtë plan. Me qëllim të zbatimit të këtij plani, komunat kanë zhvilluar një numër të lartë të projekteve kryesisht në objektet shkollore dhe në Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare si dhe në objektet publike të tjera të komunës.

3.3 Statistikat

Konform Ligji nr. 03/1-237 për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, 9 komuna kanë filluar përgatitjet për regjistrimin e popullsisë ndërsa në 29 komuna (*Shtime, Malishevë, Suharekë, Mamushë, Lipjan, Novobërdë, Gjakovë, Vushtrri, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Kaçanik, Pejë, Rahovec, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Klllokot, Mitrovicë Jugore, Partesh, Podujevë, Prizren, Zveçan, Hani Elezit, Kamenicë, Viti, Ranillug*) ende nuk kanë filluar përgatitjet.

3.4 Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi komunat janë të obliguar të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji dhe sipas të dhënave zyrtare mund të shohim se deri më tani 21 komuna kanë caktuar zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 17 komuna (Ranillug, Novobërdë, Zubin Potok, Klinë, Kaçanik, Deçan, Junik, Gllogoc, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Hani Elezit, Prizren, Fushë Kosovë) ende nuk e kanë të caktuar. Kurse sa i përket zyrtarit përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë 31 komuna të cilat i kanë caktuar këta zyrtarë ndërsa në 7 komuna (Shtime, Malishevë, Novobërdë, Zubin Potok, Gllogoc, Leposaviq, Deçan) nuk janë caktuar ende.



Grafikoni 3: Caktimi i zyrtarit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe zyrtarit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

